



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1323/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesat e Bekim Leci në cilësinë e Kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër Komisionerëve të Vendotimeve QV1026D/02R, QV1009D/01R, QV1024D/01R, QV1022D/01R, QV1002D/01R, QV1001D/03R/04R/06D, QV1029D/02D, për shkak të vjedhjes së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e Bekim Leci, në cilësinë e Kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me numër: Anr.1323/2013, Anr.1324/2013, Anr.1325/2013, Anr.1326/2013, Anr.1327/2013, Anr.1328/2013, Anr.1329/2013, Anr.1330/2013 dhe Anr.1335/2013 të datës 24.12.2013.

Arsyetim

PZAP, ka pranuar ankesat, Anr.1323/2013, Anr.1324/2013, Anr.1325/2013, Anr.1326/2013, Anr.1327/2013, Anr.1328/2013, Anr.1329/2013, Anr.1330/2013 dhe Anr.1335/2013, me 24.12.2013 nga Bekim Leci, në cilësinë e Kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga subjekti politik AAK, me të cilat pretendohet se:

Në ankesën Anr.1323/2013, parashtruesi i ankesës pretendon se në bazë të votuesve të tij të sigurt (kushërinjve), dyshon se në Vendvotimin QV1026D/02R në Hodonoc i janë vjedhur votat në Nr.8- AAK për asamble komunale.

Në ankesën Anr.1324/2013, parashtruesi i ankesës thekson se në bazë të votuesve të sigurt dyshon se në vendvotimin QV1009D/01R në Roganë i janë vjedhur votat në nr.8- AAK për asamble komunale.

Në ankesën Anr.1325/2013, parashtruesi i ankesës thekson se në bazë të votuesve të sigurte, dyshon se në vendvotimin QV1024D/01R në Koretin i janë vjedhur votat për numrin 8.

Në ankesën Anr.1326/2013, parashtruesi i ankesës thekson se duke u bazuar në votuesit e tij të sigurte dyshon se Endrit Fera, komisioner i AAK-së, në vendvotimin QV1022D/01R, në Karaqevë të Ulët, ja ka vjedhur dhe keqpërdorur votat për asamble

komunale për numrin 8, që sipas parashtruesit ishte numri i tij në listën e AAK-së, për asamble komunale.

Në ankesën Anr.1327/2013, parashtruesi i ankesës thekson se bazuar në votuesit e tij të sigurte (familjarë) dyshon se i janë vjedhur votat dedikuara për Nr.8, për asamble komunale, në Qendrën e Votimit QV1002D/01R, në Topanicë.

Në ankesën Anr.1328/2013, parashtruesi i ankesës thekson se në QV1001D/04R, dyshon se i janë vjedhur votat për Nr.8.

Në ankesën Anr.1329/2013, parashtruesi i ankesës dyshon se në vendvotimin QV1001D/03R, i janë vjedhur votat për numrin 8 në AAK për asamble komunale.

Në ankesën Anr.1330/2013, parashtruesi i ankesës thekson se bazuar në fakte të votuesve në QV1001D/06D, në Kamenicë i janë vjedhur votat e dedikuara për numrin 8 si kandidat për asamble komunale.

Si dhe në ankesën Anr.1335/2013, parashtruesi i ankesës thekson se në QV1029D/02D në Kopërnice, dyshon se i janë vjedhur votat.

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i në bazë të nenit 117.2 të Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP-së ka shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre dhe të provave tjera që gjenden në shkresa të lëndës, duke konsideruar se nuk është e nevojshme caktimi i seancës dëgjimore ka gjetur se:

Ankesat janë të pabazuara

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të theksuara në ankesat Anr.1323/2013, Anr.1324/2013, Anr.1325/2013, Anr.1326/2013, Anr.1327/2013, Anr.1328/2013, Anr.1329/2013, Anr.1330/2013 dhe Anr.1335/2013, nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës me asnjë dëshmi nuk i ka argumentuar pretendimet të cilat i ka theksuar në ankesat e tij.

Andaj, bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) i cili parasheh se: *PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet*, PZAP-i vendosi si në dispozitivë të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1323/2013 më datën 27.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

